REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 979 prot. Elbasan, më 26.04.2021

**VENDIM**

**Nr. 08 datë 26.04.2021**

**"PËR**
**MIRATIMIN E PROJEKTIT KËRKIMOR-SHKENCOR DHE ZHVILLIMIT " RRITJA E KAPACITETEVE KËRKIMORE SHKENCORE TË PROFESIONEVE MJEKËSORE TEKNIKE NË QARKUN E ELBASANIT"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 38, , në Statutin e UE-së, në Udhëzimit të MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, me propozim të njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Senati Akademik më datë 26.04.2021

**V E N D O S I**

1. Të miratojë projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimit "Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit", sipas tekstit që i bashkëlidhet vendimit.
2. Ky projekt do të zbatohet nga departamentet e: Infermieristikës, Lëndëve Paraklinike, Lëndëve Klinike, Specialiteteve Tekniko Mjekësore.
3. Produkt i projektit është hapja e programit të studimit "Doktoratë në shkencat mjekësore teknike" në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.
4. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit të UE-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Prof. Dr. Skender TOPI**

Adresa: Rruga "Ismail Zyma", Elbasan, Tel. +355 54 252593, .uniel.edu.al, info@uniel.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**

# PROJEKTI

## RRITJA E KAPACITETEVE KËRKIMORE SHKENCORE TË PROFESIONEVE MJEKËSORE TEKNIKE NË QARKUN E ELBASANIT

Prill 2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" - ELBASAN

## Tabela e përmbajtjes


PASQYRA PËRMBLEDHËSE E PROJEKTIT .......... 3

KONTEKSTI .......... 4

PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT .......... 5

PËRSHKRIMI I INSTITUIONIT TË ARSIMIT TË LARTË KU DO TË IMPLEMENTOHET PROJEKTI .......... 6

PËRSHKRIMI I BASHKIMIT TË NJËSIVE QË DO TË IMPLEMENTOJNË PROJEKTIN .......... 7

PËRSHKRIM I DETAJUAR I PROJEKTIT .......... 9

METODOLOGJIA E PROJEKTIT .......... 13

ORGANIZIMI I STUDIMEVE DOKTORALE .......... 14

PRODUKTE TË PROJEKTIT DHE AKTIVITETE TË LIDHURA ME PROJEKTIN .......... 15

ANALIZA SWOT .......... 16

ANALIZA E TREGUT TË PUNËS .......... 18

GRUPI I PUNËS PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT .......... 21

FINANCIMI I PROJEKTIT .......... 22



-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

# PASQYRA PËRMBLEDHËSE E PRODUKTIT TË PROJEKTIT

| | |
|---|---|
| Fusha kryesore e kërkimit : | Shëndet |
| Emërtimi i programit të studimeve të doktoratës | Doktoratë "Në shkencat mjekësore teknike" |
| Cikli i studimeve: | Cikli i tretë |
| Lloji i programit: | Doktoratë |
| Njësia bazë | Departamenti i Infermieristikës,<br>Departamenti i Lëndëve Paraklinike<br>Departamenti i Lëndëve Klinike,<br>Departamenti Specialiteteve Tekniko-Mjekësore |
| Njësia kryesore | Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike |
| Studimi me kohë normale, shprehur në vite: | 3 |
| Studimi kohë të zgjatur, shprehur në vite: | 5 |
| Gjuha e studimit: | Shqip |
| Të dhënat për Koordinatorin e Doktoratës: | Prof.as.dr. Shkëlqim Hidri<br>Pozicioni në IAL: Dekan i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike<br>E-mail: shkelqim.hidri@uniel.edu.al |

# KONTEKSTI

Sektori i shëndetësisë vazhdimisht po pëson ndryshime dhe reforma strukturore, si rezultat i rritjes së kërkesave ndaj kujdesit shëndetësor në përgjithësi, kujdesit për të sëmurët kronikë, personat me shumë sëmundshmëri popullatat në plakje, vlerësimi i teknologjisë si dhe problematika të qëndruseshmërisë së sistemeve shëndetësore. Sektori i shëndetësisë ka përparuar me të shpejtë edhe si pasojë e ndryshimeve të shpejta në modelet e ofrimit ndërprofesional (Armstrong & Kendall, 2010). Këto ndryshime dhe reformat, të kombinuara me mungesën aktuale të rritjes ekonomike tregojnë se strukturat ekzistuese të shëndetit, sistemet dhe mënyrat e tyre tradicionale të funksionimit, nuk janë më të vlefshme dhe nuk mund të plotësojnë të ardhmen për kërkesat shëndetësore. Kjo rezulton në nevojën për më shumë ngritje dhe fuqizim të kapaciteteve, si një mënyrë për të adresuar çështjet themelore dhe sfidat.

Ndër të tjera, mungesa e kapacitetit menaxherial ka ndikuar për joefikasitetin e shumicës së sistemeve shëndetësore (OBSH, 2007) Sistemet e kujdesit shëndetësor kanë nevojë për një udhëheqje të fortë nëse ato do të jenë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme ndaj shëndetit, nevojave të së ardhmes etj. (Ireri et al., 2011). Sipas OBSH (2007), udhëheqja efektive dhe menaxhimi në shërbimet shëndetësore janë çelësi për përdorimin e burimeve në dispozicion në mënyrë efektive dhe arritjen e rezultateve të matshme. Sidoqoftë, zhvillimi i menaxhimit të përshtatshëm, aftësive udhëheqëse dhe kompetencat, janë të nevojshme për shërbime të shëndetshme (Rowe et al., 2010).

Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore, të profesioneve mjekësore teknike, konsiston në promovimin e një mjedisi që rrit potencialin e individëve, organizatave dhe komuniteteve për të marrë dhe poseduar njohuri dhe aftësi. Gjithashtu, rritja e kapaciteteve nënkupton dhe mënyrën për t`u kualifikuar në planifikimin, zhvillimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e aktiviteteve të lidhura me shëndetin, në përputhje me ndryshimin ose shfaqjen e nevojave. Kapaciteti i kërkimit që zhvillon aftësi dhe struktura për ta lehtësuar atë mund të shihet si një komponent kritik i kapacitetit të përgjithshëm brenda një profesioni. Prandaj, lidhja midis ndërtimit të kapaciteteve kërkimore, paraqet një çështje me rëndësi maksimale për disiplinën e shkencave mjekësore teknike.

Nga një studim i kryer nga Instituto de Salud Carlos III. Nursing Research in Europe: a scoping report. Madrid, Spain: Instituto de Salud Carlos III, 2005, janë identifikuar gjetjet nga raporti i studimit të fushës në kërkime infermierore në Evropë, duke identifikuar fondet joadekuate dhe kapaciteti 'i dobët' i stafit, për të ndërmarrë kërkim dhe zhvillim. Financim i pamjaftueshëm dhe mungesa e infrastrukturës, kërkon realizimin e kërkimeve në fushën e shkencave mjekësore teknike, si forma më e avancuar e rritjes së cilësisë.

Projekti "Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore e profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit" udhëhiqet nën moton "shëndet për të gjithë" duke ofruar një sistem shëndetësor që të mbrojë, të përmirësojë dhe të promovojë shëndetin, produktivitetin dhe mirëqënien, duke ofruar shërbime efikase shëndetësore e mjekësore dhe duke u kujdesur për një progres të qëndrueshëm në shëndetin publik.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

# PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

Projekti "Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit", ka si mision formimin e një gjenerate të kualifikuar të profesionistëve të shëndetësisë, në përputhje me Ojektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, nëpërmjet realizimit të kërkimit shkencor efektiv e zhvillimor. Në bazë të projektit, qëndron rëndësia e arsimit, si përcaktues i rëndësishëm shoqëror për shëndetin. Formimi, arsimimi e shprehitë profesionale si dhe arsimimi universitar kërkimor shkencor, shërbejnë si nxitës për të hyrë në tregun e punës, për të dalë nga varfëria dhe për të rritur përfshirjen sociale. Mbi këtë arsyetim, implementimi i projektit orientohet drejt krijimit të Programit të Doktoratës "Në shkencat mjekësore teknike". Nëpërmjet zbatimit të këtij programi, do të nxitet veprimtaria kërkimore shkencore dhe e zhvillimit, duke e fuqizuar rolin e Universitetit të Elbasanit si një lider rajonal në kërkimin shkencor në fushat e shkencave mjekësore teknike, duke promovuar bashkëpunimin e ndërsjelltë midis kërkuesve, për të ushtruar në vijim detyrat si akademikë, kërkues dhe menaxhues shëndetësorë në standardet më të larta bashkëkohore.

Projekti, nëpërmjet implementimit të kërkimeve individuale, kërkohet t'i jepen zgjidhje sfidave aktuale dhe atyre në të ardhmen, duke trajtuar tematika që lidhen me pediatrinë, kirurgjinë, shëndetin publik, shëndetin mendor, sëmundjet e brendshme, epidemiologjinë, shëndetin e nënës dhe të fëmijës. Për këtë arsye, është menduar që projekti të hartohet për një periudhë pesëvjeçare, nga momenti i miratimit të tij në organet kolegjiale të institucionit të arsimit të lartë.

**Objektivat e projektit mund të përmblidhen si në vijim:**

- Studimi për herë të parë në shkencat mjekësore teknike, referuar nevojave dhe domosdoshmërisë së studimit dhe kërkimit shkencor në Qarkun e Elbasanit.
- Pëmirësimi i kurrikulës universitare në të tre ciklet për fushat e kërkimit në shkencat mjekësore teknike.
- Qendërzimi i Universitetit të Elbasanit në Research-based University.
- Organizimi i studimeve të doktoratës mbi programe individuale për aftësim të pavarur në kërkimin shkencor; në përputhje me projektin e kërkimit dhe zhvillimit të njësisë kryesore.
- Aftësimi dhe nxitja drejt veprimtarive krijuese të studentëve për një analizë kritike, për situatën duke trajtuar tematika që lidhen me pediatrinë, kirurgjinë, shëndetin publik, shëndetin mendor, sëmundjet e brendshme, epidemiologjinë, shëndetin e nënës dhe të fëmijës.
- Zhvillimi i aftësive të studentëve për publikimin e rezultateve kërkimore dhe organizimin e aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Rritja e kapaciteteve shëndetësore komunitare dhe rajonale. Akomodimi i një game të gjerë profesionesh që duan të kontribuojnë si kërkues në fushën e shëndetit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

## PËRSHKRIMI I INSTITUIONIT TË ARSIMIT TË LARTË KU DO TË IMPLEMENTOHET PROJEKTI

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", i themeluar në vitin 1991, është institucion i rëndësishëm arsimor e shkencor në Republikën e Shqipërisë, një nga universitetet më në zë të vendit për përgatitjen e mësuesve, të specialistëve dhe studiuesve të rinj në fusha të ndryshme të studimeve. Historia e tij ka njohur arritje të dukshme në shumë fusha të veprimtarisë së procesit mësimor dhe kërkimor. Universiteti është ngritur mbi një traditë të pasur në këtë drejtim. Pa dyshim kjo traditë ka të bëjë dhe është e lidhur ngushtë me Shkollën Normale, të çelur më 1909, e cila luajti për shumë kohë rolin e një universiteti të vërtetë. Sot, Universiteti i Elbasanit, vazhdon traditën arsimore në fushën e mësuesisë por edhe në fusha të reja e dinamike të dijes e kërkimit shkencor. Veprimtaria e Universitetit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në Ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UE-së si dhe në rregulloret që miratohen në zbatim të tij.

Në mënyrë të detajuar në UE funksionojnë:

I. Fakulteti i Shkencave Humane, me programe studimi Bachelor, Master profesional, Master i shkencave dhe Doktoratë në fushat e kërkimit të tij: gjuhë shqipe dhe të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht), histori, gjeografi, gazetari, albanologji, programe profesionale dyvjeçare në sekretar i specializuar dhe operator turistik në gjuhën gjermane.

II. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: biologji, kimi, botanikë, zoologji, mbrojtje mjedisi, matematikë, fizikë, teknologji e informacionit, informatikë, gjeometri, fizikë teorike e eksperimentale si dhe programe profesionale dyvjeçare në teknik laboratori, teknik mjedisi, mekatronikë, logjistikë .

III. Fakulteti i Shkencave të Edukimit, me programe studimi Bachelor, Master profesional në fushat e kërkimit të tij: mësuesi për ciklin fillor (klasës I-IV të shkollës 9-vjeçare), edukatorë për arsimin parashkollor, psikologji, filozofi, sociologji, edukim fizik dhe artistik si dhe program profesional dyvjeçar në edukator për moshat 0-3 vjeç.

IV. Fakulteti Ekonomik, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: administrim, biznes, financë, kontabilitet, ekonomia dhe e drejta, shkenca juridike në biznes, shkenca juridike në sektorin publik, ekonomi turizëm, administrim biznes dhe inxhinieri dhe informatikë ekonomike.

V. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: infermieri, infermieri mami, teknik laboratori, imazheri, manaxhim infermieror, fizioterapi dhe logopedi

Që nga themelimi i UE-së (1991) e në vijimësi punohet për krijimin e strukturave dhe institucioneve ndihmëse për procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore. Si

kërkesa të natyrshme të ristrukturimit të UE-së dhe si ndihmëse në procesin e mësimdhënies, janë ngritur e janë vënë në dispozicion laboratorë teknikë pranë secilës njësi kryesore.

Bashkërendimi i orëve teorike në të gjitha programet e studimit me orët e praktikës në laboratorë apo pranë institucioneve bashkëpunëtore të UE-së, ka krijuar një ridimensionim të hapësirës së studentit. Politikat institucionale me në qendër studentin, kanë krijuar hapësira të pafundme për ndërkombëtarizimin e UE-së, duke u ofruar studentëve mundësi të barabarta të pjesëmarrjes në programet e mobilitetit jashtë vendit. Gjithashtu kjo politikë është integruar me partneritete brenda dhe jashtë vendit, për të realizuar trajnime e kualifikime të ndryshme.

Politika e ndërkombëtarizimit ka patur një shtrirje të gjerë mes personelit të UE-së. Kjo ka mundësuar shkëmbime të personelit me universitetet partnere si dhe ka nxitur e kontribuar në rritjen e kapaciteteve, në kuadër të projekteve për ngritjen e kapaciteteve të Bashkimit Evropian. Kjo ka sjellë si pasojë një sërë aktivitetesh ndërkombëtare në UE.

Koncepti për të ardhmen e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" mbështetet jo thjesht në afërsinë e tij pranë tregut të punës, transaksioneve dhe sferës utilitare, por, pse jo, edhe i shkëputur prej tyre, pasi misioni i universiteteve nuk duhet të jetë vetëm që të prodhojë punëtorët dhe specialistët e fushave të ndryshme të kulturës dhe prodhimit, por edhe të formojë mbrojtës dhe sigurues të lirive e të drejtave shoqërore dhe qytetare në Shqipëri.

## PËRSHKRIMI I BASHKIMIT TË NJËSIVE QË DO TË IMPLEMENTOJNË PROJEKTIN

Për realizimin e projektit, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me qëllim realizimin e programit të ciklit të tretë Doktoratë në Shkencat Mjekësore Teknike. Njësitë bazë, të cilat do të implementojnë projektin janë:

| NJËSIA BAZË | NJËSIA KRYESORE |
|---|---|
| Departamenti i Infermieristikës | FSHMT |
| Departamenti i Lëndëve Klinike | FSHMT |
| Departamenti i Lëndëve Paraklinike | FSHMT |
| Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore | FSHMT |
| Departamenti i Biologjisë | FSHN |

FSHMT që nga fillimet e tij në vitin akademik 2001-2002 ka ardhur gjithnjë në rritje, fillimisht me programin e studimit "Infermieri e Pergjithshme", më pas programet e tjera të hapura në vitet pasuese. Aktualisht, fakulteti ka 6 programe studimi bachelor: "Infermieri e Përgjithshme"; "Infermieri-Mami", "Fizioterapi", "Imazheri", "Teknik Laboratori" dhe "Logopedi".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

FSHMT gjithashtu përveç ciklit të parë të studimit ka edhe 8 programe të ciklit të dytë të studimit, 6 cikle studimi Master Profesional dhe 2 Master i Shkencave:

| | |
|---|---|
| MP në "Menaxhim Infermieror" | MP në Fizioterapi |
| MP në "Infermieri Kirurgjikale" | MP në Teknik Imazherie |
| Msc në "Infermieri" | MP në Teknik Laboratori |
| Msc në "Mami" | MP në Logopedi |

Numri i studentëve, që studiojnë në këtë fakultet është mbi 2200 dhe vazhdon të rritet, siç e tregon dhe numri i lartë i aplikantëve vitet e fundit, duke u bërë fakulteti lider i UE-së përsa i përket aplikimeve dhe regjistrimeve si dhe zgjedhje e parë e maturantëve të Qarkut të Elbasanit, por jo vetëm. Fakulteti funksionon prej afro 18 vjetësh dhe ka përgatitur disa breza kuadro të lartë infermierë me sistemin e Bolonjës me një program evropian 3 + 2, bachelor e më pas master profesional e master i Shkencave. Ndër vite në këtë Fakultet kanë dhënë mësim me dhjetra pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm me përkushtim dhe përgatitje të lartë profesionale.

Nga bashkëpunimi me universitete dhe institucione të ndryshme vendase e të huaja, fakulteti ka përftuar prej tyre një kontribut shumë të rëndësishëm ndër vite. Konsolidimi i programeve të studimit Infermieri e përgjithshme dhe Infermieri-mami (por edhe në programet e tjera të studimit të hapura me vonë) ka ardhur gjithmonë në rritje përmes përvojave pozitive dhe nëpermjet kualifikimit të pedagogëve tanë, ashtu sikurse edhe atashimit të përvitshëm të pedagogëve me përvojë të fakulteteve të tjera të UE-së, FSHMT Tiranë, Fakultetit të Mjekësisë Tiranë, si dhe pedagogëve të ftuar nga Università degli Studi dell'Aquila (Itali), Università degli Studi di Bari Aldo Moro (Itali), të cilët i kanë dhënë një tjetër dimension procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës është formuar në vitin 1992. Degët (sot Programet e studimit) Matematikë-Fizikë dhe Biologji-Kimi janë hapur në vitet 1969-1970, me sisteme të ndryshme studimi (me dhe pa shkëputje nga puna; sistem 3-vjeçar studimi dhe më vonë pas viteve 1980 u hap sistemi 4-vjeçar). Në vitin 1982 u hap dega 4 vjeçare ditën. Në vitin 1992 u inkuadruan në Fakultetin e Shkencave të Natyrës degët Matematikë-Fizikë dhe Biologji-Kimi.

Programi i studimit në Biologji-Kimi ka përgatitur për dekada mësues biologjie e kimie të një niveli të lartë. Kjo është bërë e mundur edhe nga aktivizimi i pedagogëve shumë të përgatitur me grada e tituj shkencorë, si të brendshëm edhe të jashtëm. Bashkëpunimi shumë i mirë me Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT, ka dhënë kontribut shumë të rëndësishëm në konsolidimin e Degës Biologji-Kimi. Misioni i Fakultetit të Shkencave të Natyrës sot është zhvillimi i tij në mënyrë që te jetë në lartësinë e duhur me nevojat e kërkesat e tregut të punës. Për këtë arsye, në vitin 2009 u hap programi i studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi"

Personeli akademik i fakultetit përbëhet një staf i kualifikuar me grada dhe tituj (rreth 70%), ku përmendim 4 profesorë, 15 profesorë të asociuar, 10 doktorë shkencash e docentë, pjesa tjetër

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

doktorante ose Master i Shkencave dhe në vijim të mëtejshëm kualifikimi. Stafi mësimdhënës i brendshëm mbulon pjesën më të madhe të mësimdhënies në programet e fakultetit.

## PËRSHKRIM I DETAJUAR I PROJEKTIT

Sistemi shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik. Shteti siguron shumicën e shërbimeve të ofruara për popullsinë në fushën e promovimit, parandalimit, diagnostikimit, trajtimit dhe rehabilitimit. Sektori privat mbulon shumicën e shërbimit farmaceutik, shërbimin dentar dhe disa klinika të specializuara diagnostikuese dhe spitale, të përqendruar kryesisht në Tiranë. Shërbimi diagnostikues dhe kurativ shëndetësor është i organizuar në tri nivele: shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe terciar. Shërbimi shëndetësor publik dhe promocioni ofrohen në kuadër të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor dhe mbështeten e mbikëqyren nga Instituti i Shëndetit Publik dhe drejtoritë e shëndetit publik në qarqe. Shërbimet shëndetësore në kujdesin parësor dhe kujdesin spitalor blihen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Sipas ligjit, sigurimi shëndetësor është i detyrueshëm për të gjitha grupet ekonomikisht aktive dhe joaktive të popullatës. Fondi financohet përmes integrimit të taksave mbi pagën (3.4%) dhe të ardhurave të përgjithshme buxhetore në emër të grupeve joaktive të popullsisë. Regjistrimi vullnetar ofrohet për ata që nuk mbulohen. Kontributet e sigurimeve shëndetësore u rritën nga 23,02% e të ardhurave të Fondit në vitin 2013, në 27% për vitin 2015 (Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë 2016).

Në përgjithësi, sistemi shëndetësor publik vuan nga numri i pamjaftueshëm i profesionistëve. Raporti mjekë për banorë është 1.2:1000 dhe raporti mami/infermierë për banorë është 3.6:1000. Burimet njerezore në shëndetësi janë shpërndarë në mënyrë të pabarabartë[1]. Mjekët specialistë janë përqendruar në Tiranë dhe në disa qytete të mëdha. Një arritje e sistemit është ngritja dhe bërja efektive e sistemit të edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë (mjekë, stomatologë, farmacistë). Përfundimi i ciklit të parë të këtij procesi ofroi një mundësi për të përmirësuar praktikën dhe për të zgjeruar edukimin në vazhdim edhe për infermierët. Mbetet shumë për të bërë për të arritur standardizimin e nivelit profesional, motivimit dhe shpërndarjes së personelit shëndetësor sipas aftësive dhe kompetencave në vendin e punës.

Në spitalet rajonale në qarkun e Elbasanit 72% e të punësuarve, janë diplomuar pranë Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Referuar të punësuarve si personel akademik apo ndihmës akademik, pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, 50 % e personelit janë ish studentë të këtij fakulteti

[1] Spitali Rajonal Elbasan, i cili ka në përbërje 96 mjekë, 280 infermierë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

Projekti "Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit", ka si synim të punojë drejt një qasje të re, drejt formimit kërkimor shkencor të këtyre kapaciteteve, duke ridimensionuar rolin e tyre drejt referencës akademike.

Angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë harmonizohen me ambiciet për zhvillimin social dhe ekonomik, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Kërkesat përafruese me standardet e BE-së kanë epërsi në agjendën e çdo sektori, përfshirë shëndetësinë. Kuadri strategjik i OBSH-së, "Shëndet 2020", vendos theksin në shëndetin, jo thjesht në sistemin shëndetësor, duke zgjeruar spektrin e përcaktuesve të shëndetit përtej atyre konvencionale. Ky vizion përforcohet nga pozicioni më qendror dhe përparësor i shëndetit në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, përkufizimi holistik i shëndetit dhe koncepti "shëndet në të gjitha politikat". Ka një qasje tjetër për përkufizimin e shëndetit te vetëmenaxhimi i sëmundjeve. Fokusi drejt kësaj është për të ndihmuar pacientët kronikë të menaxhojnë sëmundjet e tyre. Ky projekt ndihmon në këtë drejtim duke patur parasysh që afërsisht 50% e popullatës ka një sëmundje kronike.

Realizimi i studimeve të doktoratës është një nevojë e njëkohësisht një domosdoshmëri për universitetet rajonale. Sipas raportit të Word Bank Document[2], sistemet e arsimit të lartë në vendet e Evropës Juglindore janë të pabalancuara. Një universitet i vetëm (zakonisht në kryeqytet) dominon gjithë sistemin përsa i përket numrit të regjistrimeve dhe burimeve. Për këtë arsye, plotësimi i një kuadri formativ kërkimor, shkencor dhe zhvillimor, të plotë të ofrimit të cikleve të studimit në UE, identifikohet si një problematikë, e cila rregullohet nga çelja dhe mirëfunksionimi i studimeve të doktoraës.

Sipas INSTAT (http://www.instat.gov.al/media/8185/press-release-statistika-te-regjistrimeve-2020-21.pdf) , për vitin akademik 2020-2021 paraqitet një rritje e numrit të studentëve në fushën "Shëndet dhe mirëqenie" me 4,9 %. Kjo rritje identifikohet edhe në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, ku numri i studentëve është gjithnjë e në rritje. Kualifikimi i vazhduar i studentëve në fushën e shkencave mjekësore teknike do të realizonte edhe përmbushjen e politikës së ***brain gain***, ku studentë të diplomuar të mos largohen për të punuar jashtë vendit, por të vazhdojnë kualifikimin e më pas të integrohen në profilin e kërkuesve të rinj apo lektorëve në këtë institucion.

Drejtimi kryesor në të cilin synon të zhvillohet arsimi i lartë, është kërkesa për **universitete sa më cilësore, të orientuara drejt kërkimit shkencor** (http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab1). Niveli më i lartë i kërkimit shkencor zhvillohet pikërisht në ciklin e tretë të studimeve. Si mësimdhënia, si **zhvillimi profesional në fushën e**

[2] Toby Linden, Nina Arnhold dhe Kirill Vasiliev, From Fragmentation to Cooperation: Tertiary Education, Research and Development in South Eastern Europe, Copyright © 2008 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore, Qershor 2008, Uashington, D.C., SHBA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

**shëndetit kanë nevojë të aplikohen mbi bazën e evidencave shkencore**, ndaj është shumë e rëndësishme që si stafet akademike, si personeli shëndetësor të kenë masivisht formim doktoral.

Për shkak të mungesës së ciklit të tretë të studimeve në shkencat mjekësore teknike në Universitetin e Elbasanit, është realizuar kualifikimi i personelit akademik, jashtë vendit. Kjo, jo vetëm ka rritur kostot e studimit për personelin akademik, por ka frenuar realizimin e këtyre studimeve për një pjesë të konsiderueshme të personelit, për shkak të pamundësisë financiare për t`i ndjekur këto studime. Nga një studim i realizuar me personelin akademik dhe studentë të UE-së, në profilin e shkencave mjekësore teknike, 70% e personelit akademik janë shprehur se do të ndiqnin studimet doktorale, nëse ato do të ofroheshin në Universitetin e Elbasanit. Gjithashtu 63% e studentëve janë shprehur që nëse do t`i krijohej mundësia për të ndjekur studime të ciklit të tretë, nuk do të kërkonin të largoheshin jashtë vendit, pasi konsiderojnë se plotësimi i këtij cikli do t`i ndihmonte në punësimin e tyre në këtë fushë.

Nga ana tjetër, Universiteti i Elbasanit, plotëson kërkesat akademike dhe infrastrukturore, për të realizuar ciklin e studimeve doktorale, duke shërbyer njëkohësisht si një institucion i arsimit të lartë, që për shkak të pozicionit gjeografik, ofron një shtrirje të gjerë të pjesëmarrjes së studentëve në këtë cikël studimi. Rajoni i Elbasanit përfaqëson një rajon të pasur përsa i përket projekteve kërkimore shkencore, me impakt në komunitet e më gjerë.

Për këtë arsye, projekti i studimeve të doktoratës "Në shkencat mjekësore teknike", është konceptuar si një bashkërendim i projekteve të kërkimit.

Kërkimi shkencor dhe zhvillimi, në kuadër të këtij projekti do të udhëhiqet nga modeli i praktikave më të mira, të cilat përfshijnë aspektet e mjedisit të kërkimit, trajnimin për kërkimin, udhëheqjen e kërkimit dhe të studiuesit, procedurat e kërkimit, mbrojtjen e studiuesit, përdorimin e të dhënave, punën në skuadër dhe bashkëpunimin, botimin e rezultateve të kërkimit dhe vlerësimin e kërkimit.

Deri më tani, studime dhe kërkime të vazhduara janë realizuar në përputhje me projektin, duke përfshirë publikime si:

- *Topi, Skender & Santacroce, Luigi & Bottalico, & Ballini, Andrea & Inchingolo, Francesco & Dipalma, & Charitos, Ioannis Alexandros. (2020). Gastric Cancer in History: A Perspective Interdisciplinary Study. Cancers. 12. 264. 10.3390/cancers12020264.*
- *Santacroce, Luigi & Cosola, Michele & Bottalico, Lucrezia & Topi, Skender & Charitos, Ioannis Alexandros & Ballini, Andrea & Inchingolo, Francesco & Cazzolla, Angela & Dipalma, Gianna. (2021). Focus on HPV Infection and the Molecular Mechanisms of Oral Carcinogenesis. Viruses. 13. 559. 10.3390/v13040559.*
- *Polimeno, Lorenzo & Lisanti, Maria & Rossini, Margherita & Giacovazzo, Edoardo & Polimeno, Lucrezia & Debellis, Lucantonio & Ballini, Andrea & Topi, Skender & Santacroce, Luigi. (2021). Anisakis Allergy: Is Aquacultured Fish a Safe and Alternative Food to Wild-Capture Fisheries for Anisakis simplex-Sensitized Patients?. Biology. 10. 106. 10.3390/biology10020106.*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI "ALEKSANDER XHUVANI" ELBASAN

- *Dika-Haxhirexha, Ferizat & Santacroce, Luigi & Topi, Skender & Alimani-Jakupi, Jetmire & Haxhirexha, Aulona. (2020). INTESTINAL PARASITOSIS IN CHILDREN: A BALKAN PILOT STUDY. Pharmacophore. 91-94.*
- *Santacroce, Luigi & Topi, Skender & Haxhirexha, Kastriot & Hidri, Shkelqim & Charitos, Ioannis Alexandros & Bottalico, Lucrezia. (2020). Medicine and Healing in the Pre-Socratic Thought - A Brief Analysis of Magic and Rationalism in Ancient Herbal Therapy. Endocrine, Metabolic & Immune Disorders - Drug Targets. 20. 10.2174/1871530320666200508113728.*
- *Elezi, Brunilda & Topi, Skender & Abazaj, Erjona & Bolleke, Erjola & Kasa, Marsida. (2020). Prevalence of Hepatitis C Virus and Other Comorbidities in Dialysis Population of Elbasan City, Albania. Journal of Family Medicine and Disease Prevention. 6. 10.23937/2469-5793/1510118.*
- *C La Cerra, A Dante, V Caponnetto, I Franconi, E Gaxhja, C Petrucci, BMJ open 9 (2), e025306, Effects of high-fidelity simulation based on life-threatening clinical condition scenarios on learning outcomes of undergraduate and postgraduate nursing students: a systematic.*
- *C La Cerra, A Dante, V Caponnetto, I Franconi, E Gaxhja, C Petrucci, International Conference in Methodologies and Intelligent Systems High-fidelity patient simulation in critical care area: a methodological overview.*
- *A Dante, C La Cerra, V Caponnetto, I Franconi, E Gaxhja, C Petrucci, International Conference in Methodologies and intelligent Systems Efficacy of high-fidelity patient simulation in nursing education: research protocol of 'S4NP'randomized controlled trial.*
- *Peçi Naqellari, FLORA MJEKËSORE E ELBASANIT (Vlerësim gjeobotanik). Elbasan, 2001.*
- *KALLAJXHIU, N., KAPIDANI, G., NAQELLARI, P., PUPULEKU, B., SINANI, J., KALLAJXHIU, M. (2010): Allergies caused by plants in the Elbasan region during 2004-2008. Revista Shkencore "Zei&Pari".*
- *TURKU, S., ZEKAJ, ZH., NAQELLARI, P., PUPULEKU, B.(2010): ""Morpho – karylogycal data of Aster albanicus Degen., in the area of Librazhd, Elbasan, Albania" In Fourth International Symposium of Ecologists of Montenegro (ISEM4), Budva. ISSN 1800-7155 On line edition Natura Montenegrina, Journal for Science and popular science No. 9(3): page 525 - 534 Podgorica.*


Gjithashtu, janë organizuar dhe finalizuar projektet si në vijim:

- Në Modica, Itali, u organizua si bashkëpunim mes Universitetit të Elbasanit dhe Universitetit tëAquila, Itali, Ordine dei Medici-Chirurghi e degli Odontoiatri, Provinca di Ragusa, Itali, Associazione Nazionale Dentisti Italiani, Ragusa, Itali, Konferenca Ndërkombëtare "Oral and Cervico- Facial Pathology".
- Në Universitetin e Elbasanit, "Aleksandër Xhuvani", Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, në bashkëpunim me Qendrën Spitalore, Universitetin e Barit dhe Aquila-s në Itali, organizuan Konferencën e 10-të Ndërkombëtare Mjekësore të Specialiteteve. Kjo konferencë, në tri ditët e zhvillimit të saj, mblodhi mbi 200 studiues të specialiteteve të ndryshme mjekësore nga e gjithë bota.
- Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Maqedonia e Veriut, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" dhe Universiteti i Elbasanit, organizuan konferencën ndërkombëtare "The 6-th Conference in Scientific Challenges fur Sustainable Development", në Vlorë.
- Në Universitetin e Tetovës u organizua Kongresi Ndërkombëtar i Shkencave Natyrore, Shëndetësore dhe Teknologjisë, në të cilin morën pjesë studiues vendas e të huaj. Ky

aktivitet është bashkëpunimi i rradhës i inicuar nga Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Barit dhe i Aquila, Itali.

- Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", organizoi Konferencën e Parë Ndërkombëtare në Logopedi dhe Fizioterapi. Gjatë dy ditëve të Konferencës, relatorë nga vendi dhe bota, prezantuan punimet më të fundit shkencore në fushën e mjekësisë.
- Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Universitetin e L`Aquila Itali, Universitetin e Modena, Bari, Pescara, Catania, Siena, LA Sapienza Roma, Ospdale San Paolo- Milano, organizuan Kongresin e 7, Patologia Orale e Cervico Facciale, në Aquila, Itali.

*Risia që sjell ky projekt lidhet me ngritjen në standardet më të larta të* kërkimit shkencor në fushën e shëndetit në rajonin e Elbasanit, duke e promovuar Universitetin e Elbasanit si Lider Rajonal në Kërkim Shkencor. Gjithashtu do të rrisë kapacitetet kërkimore të stafit akademik dhe personelit shëndetësor rajonal dhe do të kontribuojë në plotësimin e Universitetit të Elbasanit me personel akademik në fushat e infermieristikës, shëndetit publik dhe studimeve mjedisore, në nivelet më të larta.

*Projekti, zgjidh problematikat në lidhje me* krijimin e një mundësie për të siguruar staf akademik mjekësor të qëndrueshëm, në kushtet e mungesave për këtë kategori akademikësh në institucionin tonë. Ofrimi i kualifikimit doktoral do të ishte një mundësi më tepër për të parandaluar emigrimin e tyre. Gjithashtu, implementimi i projektit do të rrisë standardet e ofrimit të kujdesit shëndetësor nëpërmjet integrimit të njohurive shkencore dhe të vendimmarrjes së bazuar në evidenca klinike.

Projekti vjen si një vlerë e shtuar për të përballuar sfidat e kohës, duke e vlerësuar arsimin e lartë si përgjegjësi publike, duke e konsideruar universitetin si një institucion që mbështetet në dy gjymtyrë të së njëjtës peshë e rëndësi: mësimdhënie dhe kërkim shkencor; për t'iu përgjigjur kërkesave të ligjit "Për Arsimin e lartë e kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", duke e konsideruar kërkimi shkencor si kriter i vlerësimit institucional, rankimit dhe financimit.

## METODOLOGJIA E PROJEKTIT

Metodat në shkenca mjekësore teknike, janë mjete të domosdoshme të kërkimit, të cilat na mundësojnë që të arrijmë rezultate dhe njohuri të reja, apo t'i korrigjojmë ato ekzistuese. Metodologjia e projektit, konsiston në profilizimin e profesionistëve të rinj në fushat e për fushat e kërkimit në shkencat mjekësore teknike. Për këtë arsye, kandidatët paraqesin projekt propozimet e tyre, duke marrë në konsideratë fushën e përgjithshme të kërkimit, fushat specifike të kërkimit si dhe strategjinë dhe prioritetet e zhvillimit të vendit. Në çdo rast, projekti i kandidatit duhet të përputhet me profilin e programit të studimit respektiv.

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "ALEKSANDER XHUVANI" ELBASAN

Secili projekt kërkimor shkencor, do të ndjekë një qasje miks, do të jetë i bazuar në studime cilësore, sasiore dhe klinike. Objektivi i kërkimit shkencor është rritja e njohurive, por edhe të kuptuarit mbi realitetin shoqëror e politik. Kjo fillon me parashtrimin e një apo më shumë pyetjeve hulumtuese rreth problemit që na preokupon ose fenomenit që na intereson. Këto pyetje udhëhiqen nga një teori e cila i sfidon përmes hipotezës dhe kjo e fundit duhet t'i nënshtrohet vlerësimit dhe matjes nëpërmjet testimit që në fund rezulton me konkluzione.

Projektet kërkimore që orientojnë projektet individuale të kërkimit, konsistojnë në:

- Kërkim dhe përshkrim shkencor i ndikimit dhe lidhjeve shkak-pasojë midis sëmundjeve dermo veneriane, shëndetit të nënës dhe fëmijës etj.
- Obeziteti si një problem gjithnjë e më serioz në moshat pediatrike.
- Studim dhe vlerësim shkencor mbi ndikimin e grimcave të ajrit dhe përbërësve të tymit të duhanit në karakteristikat e vdekshmërisë nga SPOK.
- Kërkim dhe studim shkencor mbi survejancën, kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve spitalore. Lidhja shkak-pasojë e antibiotikorezistencës dhe infeksioneve spitalore kirurgjikale, si një nga faktorët kryesorë të dëmtimit të shëndetit publik të popullatës.
- Kërkim dhe përshkrim shkencor mbi ndikimin direkt të përdorimit të bimëve mjekësore në uljen e ndjeshme të rrezikut vdekjeprurës dhe invalidizues të hipertensionit arterial, obezitetit dhe aksidenteve cerebro vaskulare, si disa nga patologjitë më të përhapura që dëmtojnë rëndë shëndetin publik të popullatës.
- Kërkim dhe studim shkencor mbi vlerën mjekësore dhe teknike të përdorimit të ujërave termale të vendit tonë në parandalimin dhe kurimin e sëmundjeve të rënda reumatizmale dhe gastro intestinale.
- Korrelacioni midis ndotjes së mjedisit dhe sëmundjeve kronike të mushkërive në qytetin e Elbasanit.

Gjithashtu, gjatë studimeve doktorale, studentët do t`i nënshtrohen trajnimeve mbi metodologjinë e kërkimit shkencor, çështjet etike, përgatitjen dhe shkrimin e një artikulli për botim në një revistë shkencore, përgatitjen e një prezantimi ose posteri në një aktivitet shkencor, të dhënave mbi bibliografinë dhe paraqitjen e saj, databasa, faktori i impaktit dhe përgatitja e grafikëve të nevojshme për zhvillimin e tezës doktorale.

## ORGANIZIMI I STUDIMEVE DOKTORALE

Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese dhe viti doktoral, do të realizohet duke patur parasysh kohëzgjatjen 3 ose 5 vjet, si në vijim:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

| [illegible] | Elementët e planit vjetor (3 vite) | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| [illegible] | Formimi teorik Kërkimor shkencor | Pjesëmarrje në konferenca | Aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor | Asistencë në mësimdhënie lidhur me fushën e kërkimit | Shqyrtimi i literatures | | Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultate të pritshme |
| [illegible] | Permiresim ndrvshim i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni perkates | | Aktivitet klinik ne spital ose institucione të tjera shendetesore sipas fokusit te kërkimit | | Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura | Zbatimi i projektit | Shqyrtim i literatures dhe Analiza statistikore |
| [illegible] | Shkrimi i disertacionit | | Pjesëmarrje ne aktivitete shkencore (konferenca seminare) me interes në fushen kerkimore | Prezantimi i punimeve në departament | | Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant | Dorëzimi i disertacionit te komisioni, mbrojtja e tezës |

| [illegible] | Elementët e planit vjetor (5 vite) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| [illegible] | Formimi teorik Kërkimor shkencor | Pjesemarrje ne konferenca | Aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor | | Asistencë ne mësimdhënie lidhur me fushën e kërkimit | |
| [illegible] | | | Shqyrtimi i literaturës | | Hartimi i planit te projektit te kërkimit ku te përfshihen te pakten qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultate të pritshme | |
| [illegible] | Permirësim ndrvshim i planit te projektit shkencor ose fillimi i tij nese është miratuar nga komisioni perkates | | Aktivitet klinik ne spital ose institucione te tjera shendetesore sipas fokusit te kërkimit Shqyrtim i literatures | | Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura | Analiza statistikore |
| [illegible] | Zbatimi i projektit | | Aktivitet klinik ne spital ose institucione te tjera shendetesore sipas fokusit te kërkimit Shqyrtim i literatures | | Shqyrtimi i literatures | Shkrimi i disertacionit |
| [illegible] | Shkrimi i disertacionit | | Pjesëmarrje ne aktivitete shkencore (konferenca seminare) me interes në fushen kërkimore | Prezantimi i punimeve në departament | Perfundimi i disertacionit dhe detyrimeve te tjera si doktorant | Dorëzimi i disertacionit te komisioni mbrojtja e tezës |

# PRODUKTE TË PROJEKTIT DHE AKTIVITETE TË LIDHURA ME PROJEKTIN

Projekti, për herë të parë, do të sjellë si risi hapjen dhe funksionimin e programit të doktoratës në shkencat mjekësore teknike, në Universitetin e Elbasanit. Ky program i doktoratës, është produkti themelor i këtij projekti. Progami, i cili vjen si një nevojë, por edhe si domosdoshmëri, do të ketë si produkte të tij, kërkimet individuale të thelluara në shkencat mjekësore teknike, të materializuara në formën e disertacionit. Këto materiale do t'u ofrohen profesionistëve të qarkut

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN REPUBLIKA E SHQIPËRISË

të Elbasanit e më gjerë, do t'i dorëzohen institucioneve përkatese shëndetësore për t'i diseminuar ato, si dhe do të publikohen në faqen web të insitucionit, për t'u aksesuar nga të gjithë të interesuarit. Produktet e projekteve, do të jenë në varësi të kuotave të miratuara çdo vit, referuar kapaciteteve institucionale për organizimin e këtyre studimeve. Tematikat dhe të dhënat statistikore të prodhuara, do të prezantohen në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim promovimin e të dhënave për zgjerimin, thellimin, rikonceptimin dhe riintegrimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuara dhe të kuptuarit teorik të ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm dhe vetë procesit ku ato ndikojnë.

Doktoranti do të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 referime, 2 nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. Doktoranti, do të ketë botuar, së paku, 3 artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku është, së paku, autor i dytë.

Aktivitetet të lidhura me projektin do të jenë të ndara në tri faza. Faza e parë, është faza para implementimit të projektit, ku në fokus do të jenë aktivitetet promovuese dhe prezantimi i programit të doktoratës, nëpërmjet seancave të hapura të informimit në komunitet. Kjo fazë ka si synim të njohë dhe të prezantojë komunitetit me programin e doktoratës si dhe t'i përgjigjet nismave apo iniciativave të secilit person potencial për të ndjekur programin. Përzgjedhja e kandidatëve lidhet me plotësimin e kritereve për pranim, si dhe pikëzimin e dosjes së secilit aplikant. Pjesën më të rëndësishme të aplikimit e zë projekt propozimi i tezës doktorale.

Faza e dytë, është faza e studimeve doktorale, e cila fillon me fitimin e statusit të doktorantit, ku studenti ndjek programin individual të studimeve, referuar projektit kërkimor shkencor të paraqitur nga ai. Gjatë kësaj kohe, doktoranti është i përfshirë në aktivitetet kërkimore shkencore të institucionit si dhe në aktivitetet kërkimore shkencore jashtë vendit.

Faza e tretë, është e lidhur me promovimin dhe integrimin në marrëdhëniet e punës, të doktorantëve. Promovimi do të realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes si organizatorë të konferencave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara nga fakulteti.

## ANALIZA SWOT

Një faktor kryesor për suksesin të projektit të studimeve të doktoratës "Në shkencat mjekësore teknike" lidhet me matjen e performancës dhe kapacitetit të Universitetit të Elbasanit për

implementimin e tij. Analiza SWOT është një mjet për vlerësimin vetjak institucional dhe përfshin analizën e katër komponentëve: • Strengths → Përparësitë - Faktorët pozitivë të brendshëm • Weakness → Dobësitë - Faktorët negativë të brendshëm • Oportunities → Mundësitë - Faktorët pozitivë të jashtëm • Threats → Kërcënimet - Faktorët negativë të jashtëm.

Referuar projektit në fjalë, analiza SWOT është si në vijim:

| | | OPPORTUNITIES Mundësitë | THREATS Kërcënimet |
|---|---|---|---|
| Kërkesat e larta për t'u regjistruar në këtë program studimi është rritur ndjeshëm gjatë vitit të fundit. | Numri ende i ulët i personelit me titull, duke kufizuar numrin e kuotave për studimet e doktoratës. | Vënie në dispozicion të pakufizuar dhe përdorimi i ambienteve të laboratoreve dhe bibliotekave të IAL-së, duke ofruar vende për të punuar të dedikuara. | Rënia e ndjeshme e studentëve në ciklet e studimit për shkak se stduentët zgjedhin të largohen jashtë vendit. |
| Ecuria shumë e mirë e programeve në ciklin e parë dhe të dytë, duke i bërë sot për sot programet më të preferuara nga studentët. | Mundësitë e pakta të mbështetjes financiare nga ana e IAL, për realizimin e kërkimeve të ndryshme. | Njësia ka një tradite të shkëlqyer të organizimit periodik të konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktet e konferencës publikohen. | Rritja e emigracionit, sidomos të viteve të fundit. |
| Institucioni ka kapacitetet akademike për të organizuar programin e studimeve të doktoratës sipas projektit të propozuar. Personeli akademik mban titullin profesor dhe përputhet specialiteti i studimit të tyre me realizimin e kërkimit shkencor të vazhduar. | Mundësitë e largimit nga Shqipëria pas përfundimit të studimeve të doktoratës. | Njësia është përfituese e programve të mobilitetit të Erasmus+ me universitete partnere në Evropë, me kuota të dedikuara për ciklin e studimeve të doktoratës. | Tarifat e shkollimit do të jenë tarifa të cilat do të duhet të merren përsipër nga vetë doktoranti, sipas përcaktimit në vendimin përkatës të Bordit të Administrimit UE. |
| Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e studimeve klinike, në qendrën spitalore rajonale të qytetit të Elbasanit. | Tregu i punës është i pastabilizuar dhe ofron mundësi punësimi e financimi jo konkurruese. | | Zgjatja e afatit të studimit, duke krijuar pengesa për marrjen e doktorantëve të rinj, çdo vit, sipas kapaciteteve të personelit të angazhuar |
| Njësia është e qendrueshme me personel akademik dhe ndihmës akademik, i | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| cili ka kualifikimin e duhur por gjithashtu praktikon politikën e "derës së hapur" për studentët, ku problemet e tyre orientohen dhe marrin zgjidhje shpejt. | | | |
| Njësia ka kapacitetet teknike infrastrukturore, në lidhje me laboratoret dhe e vëna në dispozicion për realizimin e kërkimeve. | | | |
| Njësia ofron në fond të pasur librash si dhe abonimin në një nga bibliotekat më të mëdha JSTORE. | | | |

# ANALIZA E TREGUT TË PUNËS

## 1. PËRPUTHJA ME AGJENDËN 2030 PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Shqipëria dhe 192 shtete të tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara, në shtator 2015, miratuan Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qendrueshëm (https://sdgs.un.org/goals ). Një nga objektivat kryesore të kësaj agjende është dhe objektivi nr. 3 Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat.

Referuar këtij objektivi, në mënyrë explicite agjenda ka parashikuar në pikën 3.b mbështetjen ë kërkimit dhe në pikën 3.b.2 Ndihma totale për zhvillimin zyrtar për kërkimet mjekësore dhe sektorët bazë të shëndetit.

Ky objektiv, passjell domosdoshmërinë e nxitjes së kërkimit shkencor, në formimin universitar/akademik të profesioneve, sidomos ato që lidhen me shëndetësinë. Për këtë arsye, cikli i tretë i studimeve në shkencat mjekësore teknike, jo vetëm që është i munguar, por gjithashtu përshtatet me prioritetet dhe angazhimet ndërkombëtare të ndërmarra nga Shqipëria.

## 2. MBËSHTETJA NË STUDIME DHE TË DHËNA

**Ndryshimi dhe avantazhet potenciale të programit të propozuar për hapjen /riorganizim në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruar nga IAL të tjera.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

Programi i studimit Doktoratë në "Në shkencat mjekësore teknike" do të realizohet, duke plotësuar ciklin e studimeve në fushat përkatëse. Eksperienca disavjeçare e programeve të studimit në infermieri, imazheri, teknik laboratori, mami, logopedi, biologji, kimi dhe studime mjedisore, krijojnë një bazë të shkëlqyer të të dhënave dhe të diplomuarve prej brezash në UE. Gjithashtu, 85% e personelit akademik dhe ndihmës akademik të punësuar në UE, janë të diplomuar në këtë institucion. UE ka shërbyer njëkohësisht dhe si institucion ku studentët janë formuar në aspektin teorik dhe praktik, por gjithashtu dhe si një institucion punëdhënës i madh. Programet e studimit që i përputhen profilit të studimeve doktorale, janë sot më të preferuarat në UE.

Respektivisht:

| **BACHELOR (studentë)** | | **MASTERI I SHKENCAVE (studentë)** | |
|---|---|---|---|
| Infermieri e përgjithshme | 691 | Infermieri e përgjithshme | 253 |
| Imazheri | 313 | Mami | 82 |
| Fizioterapi | 323 | | |
| Infermieri-mami | 474 | | |
| Teknik laboratori | 328 | | |
| Logopedi | 145 | | |
| **MASTER PROFESIONAL (studentë)** | | **TOTALI (studentë)** | |
| Infermieri kirurgjikale | 36 | Infermieri e përgjithshme | 782 |
| Menaxhim infermieror | 55 | Imazherie | 339 |
| Teknik imazherie | 26 | Fizioterapi | 354 |
| Fizioterapi | 31 | Infermieri-mami | 556 |
| Teknik laborator | 26 | Teknik laboratori | 354 |
| Logopedi | 32 | Logopedi | 177 |

Referuar të dhënave të INSTAT, për vitin akademik 2020-21, **të dhënat paraqesin rritje të numrit të studentëve në fushën "Shëndet dhe mirëqenie" me 4,9 %.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

Fig. 5 Ndryshimi në përqindje i numrit të studentëve të regjistruar në arsimin universitar sipas fushave të studimit, 2020-21 / 2019-20



Burimi i informacionit: INSTAT, Statistika të regjistrimeve, 2020-21

Programi i ciklit të tretë, Doktoratë në "Në shkencat mjekësore teknike", është konceptuar të jetë njëkohësisht një program studimi i cili i përgjigjet nevojave kërkimore shkencore e zhvillimore të studentit, sikurse edhe nevojave të integrimit të tyre në tregun e punës, në zbatim të standardeve më të larta të kërkimit e zhvillimit të kompetencave. Ky cikël i tretë i studimit, gjithashtu ka pësuar rritje, në kërkesat e përvitshme.

Tab. 4 Të regjistruar në arsimin universitar

| Niveli arsimor | 2018-19 | | | 2019-20 | | | 2020-21 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Femra | Meshkuj | Gjithsej | Femra | Meshkuj | Gjithsej | Femra | Meshkuj | Gjithsej |
| Bachelor | 52 700 | 36 531 | 89231 | 48 742 | 33 927 | 82 669 | 43 787 | 30 595 | 74 382 |
| Master | 27 833 | 15 916 | 43749 | 26 022 | 14 091 | 40 113 | 27 621 | 13 928 | 41 549 |
| Doktoraturë | 1 131 | 734 | 1 865 | 1 296 | 844 | 2 140 | 1 228 | 789 | 2 017 |
| Programe 2 vjeçare | 1 279 | 2 919 | 4 198 | 1 921 | 3 421 | 5 342 | 2 185 | 3 664 | 5 849 |
| Gjithsej | 82.943 | 56 100 | 139.043 | 77.981 | 52.283 | 130.264 | 74.821 | 48.976 | 123.797 |

Burimi i informacionit: INSTAT, Statistika të regjistrimeve, 2020-21

3. TRENDI VENDAS DHE RAJONAL I PUNËSIMIT NË SEKTORIN KU BËN PJESË PROGRAMI I STUDIMIT DHE NEVOJA E PËRMBUSHUR E TREGUT TË PUNËS QË PLOTËSON PROGRAMI I RI/RIORGANIZUAR I PROPOZUAR NGA IAL-JA.

Referuar studimit "Rinia shqiptare 2018-2019" (http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf) i Fondacionit "Friedrich Ebert", është rritur ndjeshëm preferenca e të rinjve dhe sidomos e profesionistëve në moshë të re për të emigruar në vendet e Evropës Perëndimore dhe në veçanti në Gjermani, Hollandë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Kjo është duke shkaktuar probleme në sektorin shëndetësor në vend, duke qenë se një numër i konsiderueshëm mjekësh dhe infermierësh të synojnë apo edhe kanë shkuar në drejtim të Gjermanisë, në kërkim të një jete më të mirë.

Ky program studimi do t`i ndihmojë studentët të ndjekin një cikël të plotë drejt kualifikimit të tyre, në fushën e shkencave mjekësore teknike dhe studime mjedisore, duke rritur personelin e kualifikuar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në UE ( 43% e tyre janë me tituj dhe grada) e nga ana tjetër do të rriste numrin e profesionistëve me formim doktoral në Rajonin e

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

Elbasanit. I vetmi institucion publik që për momentin ofron doktorata në fushën e shëndetit është Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, kuotat e të cilit janë tejet të pamjaftueshme për nevojat që kanë institucionet arsimore dhe shëndetësore në vend.

Rritja e nivelit të potencialit kërkimor, në përputhje me kërkesat e tregut të shërbimeve shëndetësore, të pedagogëve të universiteteve dhe të personelit të institucioneve shëndetësore:

- do të rriste ndjeshëm kapacitetet akademike dhe kërkimore të stafit të këtyre institucioneve në përmbushje të standardeve të cilësisë të kërkuara nga ASCAL dhe Ministria e Shëndetësisë,
- do të rriste punësim stabël me të ardhura më të larta të pedagogëve dhe personelit shëndetësor.
- do të përmbushte politikat kombëtare të zhvillimit të IAL në drejtim të kërkimit shkencor.
- do të vendosë strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.

Pjesa më e madhe këtyre studentëve do të jenë të punësuar si pedagogë dhe personel shëndetësor, pasi ndërkohë i kanë përfunduar ciklet e dyta të studimeve që u lejojnë punësimin. Studimet në ciklin e tretë do t`u ofronin atyre vetëm punësim stabël dhe me të ardhura më të larta.

Për ata studentë që nuk janë të punësuar apo që do të ishin të interesuar të ndryshonin vendin e punës pas diplomimit, Këshilltari akademik që mbulon edhe pjesën e këshillimit të karrierës ka gjithë kontaktet e duhura me IAL partnere brenda dhe jashtë vendit për të dhënë rekomandimet e nevojshme për punësim.

Punësimi potencial i Studentëve.

Në përfundim të studimeve të doktoratës, kërkuesit e rinj do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme:

- Për t`u punësuar si lektorë në IAL
- Për t`u punësuar në Institucionet kërkimore-shkencore.
- Për të qenë pjesë e grupeve të punës në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Për të vazhduar punën në shërbimin shëndetësor me standarde më të larta dhe më të mirëpaguar.

## GRUPI I PUNËS PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT

| Nr. | Grada/ Titulli | Emër mbiemër | Angazhimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Prof.dr. | Skender Topi | Personel Akademik |
| 2 | Prof.dr | Mehdi Agolli | Personel Akademik |
| 3 | Prof.dr. | Sotir Mali | Personel Akademik |
| 4 | Prof.dr. | Shpëtim Qyra | Personel Akademik |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5 | Prof.as.dr | Shkëlqim Hidri | Personel Akademik |
| 6 | Prof.as.dr | Peçi Naqellari | Personel Akademik |
| 7 | Prof.as.dr | Gazment Koduzi | Personel Akademik |
| 8 | Prof.as.dr | Dasantila Tahiraj | Personel Akademik |
| 9 | Dr. | Gjergji Koja | Personel Akademik |
| 10 | PhD | Elona Gaxhja | Personel Akademik |
| 11 | Dr. | Jonida Mustafaraj | Personel Akademik |
| 12 | PhD | Armela Kapaj | Personel Akademik |
| 13 | PhD | Ylli Aliçka | Personel Akademik |
| 14 | Msc | Florian Goro | Personel Ndihmës akademik (Laborant) |
| 15 | Msc | Blerina Hyra | Personel Ndihmës akademik (Sekretar) |

## FINANCIMI I PROJEKTIT

Shpenzimet për realizimin e projektit, do të financohen nga tarifat e studimit të vetë doktorantëve, miratuar me vendim të Bordit të Administrimit të UE-së, dhe ose nga projekte të ndryshme kërkimore individuale, të mbështetura financiarisht nga AKFAL apo AKKSHI apo institucioneve të tjera financuese, ose nëpërmjet sponsorizimeve ose burimeve financiare publike e private dhe ose nga projektet kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, ku institucioni merr pjesë.

Specifikisht, për programin e ciklit të tretë, Fakulteti i Shkencave mjekësore teknike ka staf akademik në raportet 42.5% me tituj e grada dhe 57.5% me MSC. Bazuar në koeficientët e rekomanduar nga MASR për mënyrën e llogaritjes së kostos; pagën mesatare të punonjësve akademikë me titull Profesor, pagën mesatare të punonjësve ndihmës mësimorë; 11 % e shpenzimeve operative dhe 23 % e investimeve në buxhetin e parashikuar të vitit 2021, është llogaritur kosto e përgjithshme e studimeve për një doktorant në FSHMT dhe parashikohet në vlerën 1,343,473 lekë.

| Nr | Shpenzime | Lek |
|---|---|---|
| ***1*** | ***Shpenzime per pagat e sigurime shoqërore*** | ***1,065,708*** |
| - | *Paga / Prof &Prof.As* | *816,954* |
| - | *Paga personel/ndihmës* | *96,249* |
| - | *Sigurime shoqërore* | *152,505* |
| ***2*** | ***Shpenzime tjera*** | ***277,764*** |
| - | *Për shërbime* | *89,865* |
| - | *Për investime* | *187,899* |
| | *Shuma e shpenzimeve* | *1,343,473* |

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "ALEKSANDER XHUVANI" ELBASAN

Këto të dhëna i janë referuar pagës mesatare të punonjësve akademikë në fakultet, shpenzimeve të planifikuara në buxhetin e vitit 2021 dhe koeficientëve në bazë të studimeve të kryera nga MASR për numrin mesatar të studentëve doktorantë për një grup mësimor, i cili është 5 studentë, ndërkohë që numri punonjësve mësimorë për një student doktorant është 2.5 punonjës. Universitetet publike financohen kryesisht me bashkëfinancim: Grant nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e Universitetit, ndërkohë që sipas kostos së përgjithshme të studimeve për programin e studimit "Doktorant në shkencat mjekësore teknike", tarifat e shkollimit është parashikuar të përballohet 80% nga të ardhurat e krijuara nga pagesa e tarifës vjetore të studentëve doktorantë dhe 20 % nga granti i Buxhetit të Shtetit duke llogaritur kuotën prej 7 studentë me tarifën e parashikuar 150,000 lekë në vit akademik.

KOORDINATORI

Prof.as.dr. Shkëlqim Hidri

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- UNIVERSITETI "ALEKSANDER XHUVANI" ELBASAN